

DT 06/02/2020

## STATUTI

### I

## SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DEAN NDERTIM 09" SH.P.K.

### KREU I HYRJE

#### Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "DEAN NDERTIM 09" sh.p.k është themeluar nga ortakët:

**1.DENIS HASRAMA**, i biri i Asllan dhe Zana, shtetas shqiptar, i datëlindjes 28.01.1987, lindur në Vorë, Tiranë, banues ne Vorë, Tiranë, person madhor, me zotesi te pote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr. Personal I70128101L;

**2.ARDIAN XHAKONI**, i biri i Xhemali dhe Manushaqe, shtetas shqiptar, i datëlindjes 28.01.1987, lindur në Tiranë, Tiranë, banues ne Vorë, Tiranë, person madhor, me zotesi te pote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr. Personal J00109082;

Themeluesit, të cilët janë madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin hartuan edhe statutin e Shoqerise si më poshtë:

### KREU II PERKUFIZIME

#### Neni 2

#### Emërtimi i shoqerise

Emërtimi i shoqerisë është "DEAN NDERTIM 09" sh.p.k..

#### Neni 3

Asambleja e ortakeve ka vendosur miratimin e statutit te shoqerise ne baze te legislacionit ne fuqi te Republikës së Shqipërisë, vecanerisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn ne fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqeria e bazon aktivitetin e saj ne ligjin nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrencest" të ndryshuar, ne Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe ne ligje te tjera ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 4**

#### **Forma**

Shoqëria "DEAN NDERTIM 09" sh.p.k është "Shoqëri me Pergjegjësi të kufizuar" Sh.p.k.

#### **Neni 5**

#### **Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugën Industriale Tiranë-Vorë , Nr 31, Kodi Postar 1032, Vorë.
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikës se Shqipërisë ne varesi te selise Qendrore që ndodhet ne qytetin e Tiranes.
3. Vend i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se per gjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne një vend tjeter.

#### **Neni 6**

#### **Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Zbatim, projektim te ndertimeve civile, ekonomike, punime dheu, sistemim taracime, prodhime elementesh te parafabrikura, betoni e beton arme, ndertime civile e turistike, rrugesh, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karperterie, investime ne sektorin e energjetikes etj Investimi në fushën e ndërtimit civil;

Si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjisacionin Shqiptar ne fuqi.

#### **Neni 7**

#### **Vula e shoqerise**

1. Shoqeria ka vulen e saj, ne brendesi te se ciles shkruhet i plete emertimi i shoqerise dhe forma e saj juridike.
2. Te gjitha aktet qe dalin nga shoqeria, pasi nenshkruehen sipas ligjit, vulosen me vulen e shoqerise.

**Neni 8**  
**Kohezgjatja e shoqerise**

Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

**Neni 9**  
**Veprimet e lejuara te shoqerise**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimitarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Asambleja e Pergjithshme me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paken  $\frac{3}{4}$  e pjesave te kapitalit.

**Neni 10**  
**Marredheniet e punes**

1. Shoqeria per te kryer veprimitarine e saj sipas objektit te ketij statuti do te lidhe kontrata individuale per te rregulluar marredheniet e punes.
2. Kontratat e punes do te lidhen konform ligjt "Kodi i Punes së Republikës së Shqiperise" dhe dispozitave te tjera ligjore qe rregullojnë marredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

**KREU III**  
**PARIMI I DETYRIMIT TE BESNIKERISE**

**Neni 11**  
**Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur**

1. Personi i autorizuar per te perfaqesuar ose mbikqyrur shoqerine tregtare nuk mund te lidhe kontrata apo te hyje ne marredhenie te tjera me shoqerine tregtare, nese nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyren e objektin e interesit te tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithe ortakeve ose te gjithe ortakeve te tjere.
2. Cdo miratim paraprak dhe i pergjithshem njoftohet per regjisrim ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjeter, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqerinë, apo me palë të treta, marrëdhënet e të cilave me personat e mësipërm janë të tillë që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqerinë:

- a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, véllezërit ose motrat e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b) fëmijët, prindërit, véllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqerinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të térthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërm i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqerinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.
5. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.
6. Per efekt te ketij statuti, me persona te autorizuar per te perfaqësuar ose mbikëqyrur shoqerine tregtare do te kuptojme ortaket e shoqerise, administratorin, ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesin e shoqerise.

#### Neni 12

##### Parimi i besnikerise

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj ose nga ky statut, në rrethana të njëta, ortakët gjëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

#### Neni 13

##### Ndalimi i konkurrencës

1. Personat e autorizuar per te perfaqësuar ose mbikëqyrur shoqerine tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë te punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëtin sektor ekonomik me shoqerinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
2. Ndalimi i përmendor në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumice te kualifikuar.
3. Ndalimi i përmendor në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendor në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
  - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkuruese;
  - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë se cilët prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendor zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

#### **KREU IV KAPITALI THEMELTAR - PJESEMARRJA**

##### **Neni 14**

###### **Kapitali i shoqerise dhe kuotat**

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 100.000 lekë i cili përbëhet nga 2 kuota.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nëpërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtë e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufirin minimal qe lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

##### **Neni 15**

###### **Kontributet**

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga dy ortakët e shoqërisë, si vijon:

1. Ortaku **Denis Hasrama** zotëron 50 % të vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlere prej 50.000 lekë;

2.Ortaku Ardian Xhakoni zotëron 50 % të vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlerë prej 50.000 lekë;

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakut të vetëm si më sipër.

#### Neni 16

##### Kalimi i kuotave te kapitalit

1. Kuotat e kapitalit te shoqerise jane të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe te kalueshme ne rruge trashegimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhën ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit te shoqerise mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit.
3. Ne rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqerise tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjera të shoqërisë. Kur ortaket qe gezojne te drejten e parablerjes kane dyshime rreth cmimit te kuotave te ortakut qe kerkon ti kaloje ato, mund ti drejtohen gjykates qe te caktoje një ekspert vleresues. Ortaku qe kerkon kalimin e kuotave tek te tretet duhet te lajmerohet ne një afat sa me te shpejt, nese brenda 4 javave ortakut nuk i jepet një pergjigje atehere prezumohet se ortaket e tjere kane rene dakord qe kuotat e tij mund ti kalohen te treteve.
4. Kalimi i kuotave do te behet me kontrate.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

#### Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

#### KREU V

##### ORGANET E SHOQERISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

#### Neni 18

##### Asambleja e pergjithshme

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.

2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjeter apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime per ceshtjet e me poshtme dhe eshte perjegjese per to:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
  - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
  - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);

- h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;**
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;**
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;**
  - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;**
  - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.**
- 10.**Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 11.**Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;**
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;**
  - c) Investime;**
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.**
- 12.**Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
- 13.**Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se per gjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
- 14.**Asambleja per gjithshme vendos me shumice te zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.
- 15.**Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zgjelimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjeter që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve te vlefshme behet vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 70% e kuotave jane te pranishem, votojne me shkrese apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres.
- 16.**Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor në kete pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 19**  
**Administrimi**

- 1.** Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

### **Neni 20** **Kompetencat e administratoreve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligi dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

### **Neni 21** **Emerimi i pare i administratoreve**

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet ortaku **Ardian Xhakon**.

**KREU VI  
VOTA**

**Neni 23  
E drejta e votes**

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

**Neni 24  
E drejta per te kaluar rezolute**

Asambleja e per gjithshme mund te miratoje rezolute pa plotesuar kriteret e njoftimit ne kete statut apo ne ligj. Qe te miratohet një rezolute ne mbledhjen e asamblese se per gjithshme duhet te jene te pranishem te gjithe ortaket personalisht dhe ta votojne ate ne menyre te unifikuar.

**KREU VII  
MARREDHENIET FINANCIARE**

**Neni 25  
Viti finanziar**

Çdo vit finanziar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

**Neni 26  
Bilanci vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e per gjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.
3. Gjuha qe perdoret ne hartimin e dokumentave vjetore eshte gjuha shqipe.

**Neni 27  
Dividentet**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e per gjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividenteve mbi fitimin ne raport me kuotat qe gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit finanziar të cilit i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 28  
Marredheniet me bankat dhe institutet financiare**

Shoqeria ka te drejte te hap llogari likuiduese prane nje ose me shume bankave ose institucioneve financiare dhe te mund te kryeje veprime likuiduese prane bankave. Ne keto banka ose institute financiare si nenshkrim i pare do te depozitohet ai i administratorit te shoqerise, i cili duhet te nenshkruaj per te gjitha veprimet financiare ne emer e per llogari te shoqerise. Ai mund te autorizoje edhe persona te tjere brenda shoqerise.

### Neni 29

#### **Marredhenia me organet tatileve**

Veprimitaria ekonomike e shoqerise mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e te ardhurave, dhe ti depozitojne ato prane organit perkates te tatimeve.

### KREU VIII

#### **NDRYSHIMI I STATUSIT TE SHOQERISE**

### Neni 30

#### **Prishja e shoqerise**

1. Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes.

### Neni 31

#### **Likuidimi**

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që ne momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave te kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe përmbylljen e procesit të likuidimit.
3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave te kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

### Neni 32

#### **Shnderrimi i shoqerise**

Shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjeter shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

**KREU IX**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 33**

**Mosmarreveshjet**

Të gjitha mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

**Neni 34**

Për cështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjisacionit shqiptar në fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky statut nënshkruhet nga themeluesi.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

**Denis HASRAMA**

DENIS HASRAMA  


**Ardian XHAKONI**

Ardian Xhakoni  
